



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/142

Datë: 07.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 133, 134, dhe 135 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/142

Datë: 07.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/142

Datë: 07.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia për Cilësinë e Ajrit për vitin 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për vitin 2013-2017.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/142

Datë: 07.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht 2013, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të Dokumenteve Strategjike për vitin 2013

1. Në planin e dokumenteve strategjike për vitin 2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës përfshihet:
 - 1.1. Projekt-plani për zhvillimin e zonave ekonomike për vitin 2013-2018
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/142


Datë: 07.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 700,000.00 (shtatëqind mijë) euro për mbështetjen e projektit të Brezovicës, si dhe mbështetjen e prioritetëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e reformave ekonomike për përmirësimin e mjedisit afarist dhe tërheqjen e investimeve.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen si në vijim:
 - 2.1. 250,000.00 euro nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nën-programi, Agjencioni për Promovimin e Investimeve (kodi 413), kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime dhe
 - 2.2. 450,000.00 euro obligohet Ministria e Financave që t'i sigurojë nga burimet e financimit brenda muajit tetor të vitit 2013.
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi transferohen në llogari të mirëbesimit të krijuar nga USAID, e cila do të krijohet me Marrëveshjen për Llogarinë e Mirëbesimit në mes të Qeverisë të Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë të SHBA-ve të përfaqësuar nga misioni i USAID-it në Kosovë.
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë